ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **2025/101-25-3586-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: Digital Signage - Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit të integruar Digital Signage në tërë ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

STORM ICT LLC
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Str. Tahir Zajmi n.n.,
(Adresa)
Prishtina — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*
038 732 732 — ***038 732 731***
Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Elion Rexhepi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Info@STORM-ict.com
(Adresa elektronike)

01.07.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Avokat Qëndrim Arifi
(Emri i avokatit)

Rr. "Idriz Gjilani", Llamela 15, Kati 2, Nr. 213, Dardani, Prishtinë.
(Adresa e plotë)

+383 49 875 852
(Numri i Telefonit)

N/A
(Numri i faks-it)

qendrim1.arifi@gmail.com
(Adresa elektronike)

AVOKAT / LAWYER
Qëndrim Arifi
AVOKATURA ARIFI & PARTNERS SH.P.K.

01.07.2025
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Njoftimi për kontratë: 30.04.2025
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 26.05.2025
Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues: 17.06.2025
Kërkesa për Rishqyrtim:22.06.2025
Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim 25.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40.2 i RrPP-së
Neni 40.12 i RrPP-së
Neni 62.2 i RrPP-së
Neni 48.1 dhe 48.2 i Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania STORM ICT L.L.C., më datë 26.05.2025 ka dorëzuar ofertën e saj për aktivitetin e prokurimit: "**Digital Signage – Krijimi dhe mirëmbajta e sistemit të integruar Digital Signage në tërë ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës**", ndërsa më datë 17.06.2025, Autoriteti Kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së,

me të cilin ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit. Autoriteti Kontraktues e ka anuluar aktivitetin e prokurimit duke u bazuar në nenin 61.1 të LPP-së.

AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyen se kinse: *"një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit" (Neni 61.1 i LPP-së)*. Ndërsa më pas merret në mënyrë meritore edhe me ofertat konkrete të operatorëve ofertues, me çka vendimin e saj e bënë tejet konfuz dhe jo profesional. Konkretisht nuk dihet se a është anuluar aktiviteti i prokurimit për shkak se kinse specifikat paskan qenë kufizuese apo nga ajo se ofertuesit paskan qenë të pa përgjegjshëm.

STORM ICT L.L.C, më 22.06.2025 ka parashtruar Kërkesës për Rishqyrtim, ndërsa AK më 25.06.2025 nxjerr Vendim me të cilin REFUZON në tërësi kërkesën për rishqyrtim.

PROVË: Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim i datës 25.06.2025.

STORM ICT nuk është e kënaqur me Vendimin lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim, për faktin e i njëjti nuk është përpiluar konformë kërkesave ligjore dhe nuk i përgjigjet pretendimeve ankimore të parashtruara nga ne, konkretisht:

(I) RETENDIMET ANKIMORE LIDHUR ME REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Pretendimi 1: Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk i përgjigjet të gjitha pretendimeve të ngritura nga OE ankues STORM ICT

AK nëpërmjet Vendimit të datës 25.06.2025 për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim nuk i trajton të gjitha pretendimet ankimore, kujtojmë se STORM ICT kishte ngritur gjithsej 6 pretendime ankimore, ndërsa AK përkundër që liston 4 përgjigje, tri prej tyre kanë të bëjnë me pretendimin nr.1 "Orientimi i specifikimit teknik ndaj një prodhuesi të caktuar (LG)", ndërsa një përgjigje ka të bëjë me pretendimin nr. 3 "Dy OE kanë ofruar çmime identike – dyshim për marrëveshje të ndaluar", pra refuzohet Kërkesa për Rishqyrtim, pa dhënë asnjë shpjegim për 4 pretendime tjera ankimore nga STORM ICT, dhe kjo formë e vendosjes vendimin e datës 25.06.2025, e bënë arbitrar dhe të kundërligjshëm.

Konkretisht AK nëpërmjet vendimit për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk jep ASNJË shpjegim për kundërshtimet tona lidhur me pretendimet e saj se: "kemi mospërputhje materiale ndërmjet specifikacionit teknik dhe përshkrimit të çmimit", "çmim pazakontë i ulët dhe mospërputhje me vlerësimin e njësisë kërkuese" dhe "ofrimi i dy prodhuesve nga OE STORM ICT".

Vendimi i AK-së i pa arsyetuar, respektivisht pa i trajtuar pretendimet ankimore të STORM ICT L.L.C, shkelë në mënyrë flagrante **Nenin 62, par. 2 të RrPP-së**, i cili nen kërkon taksativisht se: *"**Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet** dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit"*. Përveç kësaj, Vendimi i AK-së bije ndesh edhe me **Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**, ku në **nenin 48, paragrafi 1, nënpargrafi 5**, taksativisht thekson se: *"1 Arsyetimi i siguron*

palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: (1.5.) *"shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve"*. Pretendimet kryesore të STORM ICT fare nuk janë trajtuar nga AK. Andaj, bazuar në **nenin 48, par. 2** të po të njëjtit Ligj: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*. Prandaj një akt i tillë duhet të ANULOHET nga OSHP.

Pretendimi 2:Në Vendimin për refuzim AK thekson: **"Komisioni i vlerësimit ka të drejtë të pavarur të ngris cdo shkelje ligjore të cilën e konstaton gjatë vlerësimit të tenderëve. Askund me Ligj nuk e ka të penguar këtë të drejtë. Përkundrazi është i obliguar që vlerësimin ta bëjë në pajtim me LPP"**

Këtu AK fare nuk është marr me pretendimin tonë si OE, konkretisht ne kemi potencuar se Komisioni i ka tejkaluar kompetencat e tij kur gjatë vlerësimit është marr me specifikimet teknike (pra në vend që të kryej vlerësimin sipas kërkesave të dosjes së tenderit, Komisioni është marrë me vetë kërkesat), konkretisht në vend që AK ta trajtoj pretendimin tonë karshi dispozitave ligjore të cituara, ajo vetëm citon se Komisioni është i pavarur të ngris shkeljet ligjore. Bazuar në nenin **40, paragrafi 2** të **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik** e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024 (tutje RrPP) *"Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen **<u>në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit</u>** dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve"*.

Andaj, Sipas nenit 40 të RrPP-së, Komisioni i Vlerësimit ka vetëm kompetencën për të vlerësuar tenderët në përputhje me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Komisioni nuk ka asnjë kompetencë të ndërhyjë në specifikimet teknike të hartuar nga autoriteti kontraktues, përkatësisht nga Zyrtari i Prokurimit dhe Njësia Kërkuese. Specifikimet teknike janë përgjegjësi ekskluzive e AK-së, dhe përderisa nuk janë sfiduar ligjërisht gjatë fazave paraprake (para se të hapen ofertat), ato kanë fuqi detyruese dhe duhet të zbatohen nga të gjithë palët, përfshirë edhe Komisionin e Vlerësimit. Komisioni i Vlerësimit nuk mund të rekomandojë anulimin e aktivitetit të prokurimit nëse ofertuesit i kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Ndërhyrjet e tilla në specifikime teknike, jo vetëm që janë të paautorizuara, por edhe bien ndesh me parimin e ligjshmërisë dhe objektivitetit në procesin e prokurimit publik, kështu duke shkel rëndë posaçërisht nenin 1 dhe 7 të LPP-së.

Pretendimi 3: Në Vendimin për refuzim AK thekson: **"Çdo tender vlerësohet më vete, asnjë analogji me procedurat e viteve të shkuara Komisioni i vlerësimit nuk e ka për obligim t'i marrë parasysh dhe ato s'paraqesin asnjë aspekt juridik në këtë fazë, pra gjatë vlerësimit të tenderit aktual"**

Ky qëndrim i AK-së vetëm se konfirmon pretendimin tonë se AK në mënyrë të kundërligjshme dhe të pajustifikuar ka anuluar aktivitetin e prokurimit me pretendimin se:

"një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit". Përkundër se ne si OE i kemi sjellë disa argumente se pse AK ka keqpërdor këtë mundësi ligjore, konkretisht se nuk mund ta justifikoj anulimin e aktivitetit mbi këtë bazë, dhe në këtë fazë të procedurës, për faktin se të njëjtat specifika i ka përdorur edhe në vitet paraprake, AK në vend që të "justifikoj" këtë, e njëjta vetëm potencon se: *"Çdo tender vlerësohet më vete, asnjë analogji me procedurat e viteve të shkuara Komisioni i vlerësimit nuk e ka për obligim t'i marrë parasysh".*

Fillimisht ne nuk kemi pretenduar që Komisioni gjatë vlerësimit duhet ti ketë pasur parasysh prokurimet e viteve paraprake (edhe pse nuk përjashtohet si mundësi, posaçërisht kur tendencat janë të anulohet një procedurë), mirëpo kjo ka qenë detyrë dhe përgjegjësi e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, përtej kësaj nuk duhet harruar faktin se vlerësimet e Komisionit janë të karakterit rekomandues dhe jo detyrues. Prandaj, AK nuk mund t'i ikë përgjegjësisë lidhur me arsyet e anulimit të aktivitetit të prokurimit vetëm se nuk qenka i lidhur me prokurimet e mëparshme.

Së dyti, lidhur me këtë çështje, STORM ICT në Kërkesën për Rishqyrtim i ka pasur edhe disa pretendime tjera, mirëpo AK nuk e ka trajtuar asnjërën prej tyre, e gjithë kjo për faktin se nuk mund ta justifikoj anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Prandaj, STORM ICT kërkon që edhe OSHP të mos lejoj që të legjitimohet një anulim i aktivitetit të prokurimit mbi arsyetime dhe fakte të pa qëndrueshme.

Pretendimi 4: Në Vendimin për refuzim AK thekson: "**Lidhur me specifikimin teknik, vlen të theksohet se në Komision të vlerësimit njëri anëtar është nga Njësia Kërkuese dhe ai është pajtuar plotësisht me rekomandimin e dhënë lidhur me këtë çështje (pra se kërkesa ishte e orientuar drejt prodhimeve LG). Këtë e pohojnë edhe zyrtarë të tjerë nga Njësia Kërkuese (se gjoja nuk kishte zgjidhje tjetër) dhe me një kërkesë të thjeshtë në Internet kjo mund të konstatohet**".

Për vlerësimin tonë ky arsyetim apo përgjigje, përveç se është jo profesionale në të njëjtën kohë paraqet shqetësim të jashtëzakonshëm lidhur me atë se si AK mbron dhe argumenton vendimmarrjen e saj. Konkretisht AK thirret në persona të tretë të cilët as nuk e dimë kush janë, as nuk e kemi ndonjë fakt se me të vërtetë kanë ato qëndrime që pretendon AK, por më e rëndësishmja sipas LPP-së nuk kanë asnjë relevancë. Konkretisht AK vendimin duhet ta bazoj në dispozita ligjore, e jo në thënie të personave të tretë të cilët nuk kanë asnjë rol në këtë aktivitet të prokurimit.

Përtej kësaj, Vlerësimet e Komisionit duhet të ruhen dhe mbahen sekrete derisa të nxirret Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, e gjithë kjo bazuar në nenin 40.15 të RrPP-së, ku taksativisht theksohet se: *"Gjatë kohës së vlerësimit të tenderit, informacione në lidhje me shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin, krahasimin e tenderëve, pikat e dhënë, dhe rekomandimi për dhënien, nuk do tju zbulohet ofertuesve apo ndonjë personi tjetër që nuk janë të përfshirë zyrtarisht në ekzaminimin, vlerësimin e tenderëve deri sa të jete publikuar Formulari B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK"* Prandaj, arsyetimi i AK-së mbi këtë bazë është i papranueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RrPP-së.

Pretendimi 5: Në Vendimin për refuzim AK thekson: **"Pretenduesi ankimor nuk sjell asnjë dëshmi me të cilën do ta zhvlerësonte dyshimin e bazuar të Komisionit të**

vlerësimit lidhur me cmimet e ofruara identike të të dy tenderuesve, veprim ky në kundërshtim me Ligjet në fuqi, prandaj pretendimi i tij mbetet i pabazuar"

Lidhur me këtë përgjigje të AK-së, lidhur me pretendimin tonë ankimor, fillimisht duhet theksuar se AK nuk e ka bazuar këtë pretendim të ngritur, e njëjta vetëm paragjykon por nuk ofron as edhe një provë apo fakt i cili dëshmon se kompanitë ofertuese paskan marrëveshje të fshehtë si dhe ku paska qenë i gjithë qëllimi i kësaj marrëveshja. Së dyti, nëse do të kishte pasur edhe dyshimin më të vogël, AK ka mundur që nëpërmjet Formularit Standard (Neni 72 i LPP-së) të kërkoj informata shtesë nga ne si OE, mirëpo përkundrazi në këtë pretendim të AK-së e kemi mësuar vetëm kur është publikuar Formulari B58.

Së treti, është krejtësisht e pakuptimtë dhe jo ligjore që ne të japim argumente gjatë Kërkesës për Rishqyrtim për diçka krejtësisht të pa argumentuar dhe të pa mbështetur në dispozitat e LPP-së. Andaj, do të duhej të ishte pikërisht AK ajo e cila do të argumentonte se si dhe kur dy OE-të ofertues paskan marrëveshje të fshehtë, sepse është pikërisht AK ajo që po dyshon për një gjë të tillë (pra barra e provës i takon AK-së). AK do të duhej të ishte në gjendje që vetë t'i argumentoj dhe faktoj pretendimet e ngritura për eliminim të kompanisë tonë, e jo të pres nga ne që t'i tregojmë se mbështetet ose jo pretendimi i saj i pa bazuar në asnjë fakt dhe provë.

Përfundimisht është më se e qartë se AK duke e ditur që arsyet e anulimit të aktivitetit janë jo bindëse dhe të pa bazuara në Ligj, është munduar që të "shpik" kinse shkelje tjera në mënyrë që të zmbraps kompaninë tonë nga sfidimi i këtij vendimi të kundërligjshëm në OSHP, pra të krijon përshtypjes se edhe nëse anulimi do të konstatohet i kundërligjshëm, megjithatë të jenë edhe disa pretendime tjera që përsëri STORM ICT të mos mund të shpallet fituese.

(II) PRETENDIMET ANKIMORE LIDHUR ME NJOFTIMIN MBI VENDIMIN E AK-SË TË KONFIRMUARA EDHE ME VENDIMIN PËR REFUZM TË KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Meqë edhe pas Kërkesës për Rishqyrtim, konkretisht me Vendimin për refuzim të datës 25.06.2025, AK ka qëndruar prapa pretendimeve të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 17.06.2025, me të njëjtat argumente, në vazhdim gjeni pretendimet e OE STORM ICT.

Pretendimi 6: Orientimi i specifikimit teknik ndaj një prodhuesi të caktuar (LG)

AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyen se specifikimi teknik i hartuar nga Njësia Kërkuese përmban karakteristika që i përputhen produkteve të prodhimit LG dhe se kjo mënyrë e formulimit të specifikimeve teknike krijon një kufizim të konkurrencës, duke favorizuar në mënyrë indirekte operatorët ekonomik.

Ky qëndrim i AK-së është krejtësisht i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm dhe qëllimi i vetëm është mos shpërblimi me kontratë i OE STORM ICT dhe ja pse:

a) NUK është PËRGJEGJËSI dhe as DETYRË e Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve të vlerësoj se specifikimet teknike janë ose jo të përshtatura me prodhues të caktuar. Nëse analizohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 17.06.2025 dhe Raporti i

Vlerësimit të tenderëve i datës 16.06.2025 përmbajtja është identike, pra Komisoni i tejkalon kompetencat e tij duke u marrë me atë se kinse specifikat teknike qenkan diskriminuese. Bazuar në nenin **40, paragrafi 2** të **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik** e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024 (tutje RrPP) *"Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen* ***<u>në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit</u>*** *dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".* Andaj, këtu kemi të bëjmë me tejkalim të kompetencave të Komisionit dhe kjo është në kundërshtim me nenin 40 të RrPP-së.

PROVË:

- Raporti për vlerësimin e tenderëve i datës 16.06.2025 dhe

- Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 17.06.2025.

b). Një aktivitet të prokurimit të njëjtë me këtë aktivitet, AK e kishte shpallur gjatë vitit 2023 sipas numrit të prokurimit: 101-23-3902-1-2-1, aktiviteti paraprak kishte të NJËJTAT SPECIFIKA, pra IDENTIKE me këtë aktivitet, por i njëjti ishte anuluar për këtë arsye:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i aktivitetit të prokurimit:

Furnizimi me sistem të informimit përmes monitorëve ose TV - digital signage
Numri i prokurimi: 101-23-3902-1-2-1 (KU101 23 023 121)

Në dosje të tenderit dhe te Përshkrimi i çmimit, për tri pozicione janë vendosur gabimisht karakteristikat teknike. Shih në vijim:

Pozicioni nr. 1

Aspect Ratio	**16:09**

Pozicioni nr. 2

Aspect Ratio	**16:09**

Pozicioni nr. 4

Contrast Ratio	**1000:01:00**

Këto gabime në specifika teknike, sipas LPP, shkaktojnë dilema dhe trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit.

Pra, përkundër se specifikimit teknike kanë qenë IDENTIKE, atëherë Komisioni nuk e paska identifikuar se paska specifikime diskriminuese, por ky element u vërejt tash pas tre vitesh.

PROVË:

- **Specifikimet teknike në aktivitetin paraprak me titull: Furnizimi me sistem të informimit përmes monitorëve ose TV - digital signage me numër të prokurimit 101-23-3902-1-2-1 dhe**
- **Specifikimet teknike në aktivitetin e tanishëm.**

c). Problemi nuk është me specifikimet teknike, por është me operatorin STORM ICT, në aktivitetin paraprak STORM ICT kishte ofertuar me çmim 49,250.00€, përkatësisht ishte OE më i lirë dhe e vetmja mundësi për ta privuar nga e drejta për shpërblim me kontratë ishte anulimi i aktivitetit të prokurimit, e që njëjtë ka ndodhur edhe në aktivitetin e tanishëm. Pra, me të parë se kompania tjetër konkurrente ishte administrativisht e papërgjegjshme e vetmja mënyrë për ta privuar kompaninë STORM ICT nga e drejta e saj ishte "shpikja" se kinse specifikat teknike qenkan diskriminuese.

PROVË:

- Procesverbali i hapjes i aktivitetit paraprak të anuluar me numër të prokurimit 101-23-3902-1-2-1;

- Procesverbali i hapjes në aktivitetin e tanishëm dhe Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 17.06.2025.

d). Në asnjë formë nuk qëndron pretendimi i AK-së se këto specifikime teknike të vendosura kufizojnë konkurrencën. Kjo për faktin se në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar dy kompani, si dhe nëse marrim për bazë edhe aktivitetin e njëjtë të vitit 2023, në atë aktivitet ka ofertuar edhe një kompani e tretë e cila në këtë aktivitet fare nuk ka marrë pjesë. Pra, mund të përfundojmë se këto specifika teknike i plotësojnë së paku tre operatorë ekonomik në Republikën e Kosovës, andaj çdo pretendim që duke u thirr në dispozitën e nenit 28 të LPP-së kinse përshtatje të specifikave pa argumente të qëndrueshme dhe të arsyeshme janë vetëm justifikim për të abuzuar me këto dispozita ligjore. Prokurimi Publik, as nuk ka për qëllim dhe as nuk mundet që të ofroj mundësi për secilin operator ekonomik në Kosovë, aktiviteti i caktuar në bazë të specifikave u referohet operatorëve të caktuar (varësisht nga veprimtaria), andaj prokurimin nuk duhet ta interpretojmë si diçka si "Çdo operator ekonomik mund të ofertoj për gjithçka". Pikërisht kjo logjikë është përjashtuese dhe në kundërshtim me LPP-në, duke shkelë në mënyrë flagrante nenin 1 dhe 7 të LPP-së.

e). Për këtë aktivitet të prokurimit NUK kishte ASNJË kërkesë për sqarime lidhur me specifikimet që AK po i konsideron diskriminuese, apo kërkesë kundër njoftimit për kontratë, dhe kjo në mënyrë indirekte len të kuptohet se nuk kemi pasur të bëjmë me kërkesa diskriminuese. Përtej kësaj, AK dy herë ka përdorur Formularë Standard për të korrigjuar gabimet, dhe ASNJËHERË këtë nuk e ka bërë për specifikimet që sot pas hapjes së tenderëve dhe pasi që ka parë se STORM ICT është OE potencial për tu rekomanduar për kontratë po i konsideron si diskriminues dhe të përshtatura për një prodhues të caktuar.

PROVË: Shih aktivitetin e prokurimit ku më datë 14.05.2025 dhe 15.05.2025 ka pasur të publikuar Formular B54.

Pretendimi 7: Mospërputhje me karakter material ndërmjet specifikacionit teknik dhe përshkrimit të çmimit

AK pretendon se ka mospërputhje në mes të specifikacionit teknik në Dosje, përkatësisht Aneksi 1 dhe në përshkrim të çmimit. Kjo është krejtësisht e paqëndrueshme dhe ka tendenca të kundërligjshme për të justifikuar anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Kjo për faktin se ajo që përmend AK aspak nuk përbën paqartësi dhe se përshkrimi i pozicionit 7 është identik si në Dosje të Tenderit dhe si në Përshkrim të Çmimeve, mirëpo AK përshkrimin plotësues të pozicionit në Dosje të Tenderit dëshiron ta justifikoj si gabim në paramasë. Pra secili OE i cili ka qenë i gatshëm të ofertoj është dashur të jetë i vetëdijshëm se pozicioni 7 në listë të çmimeve duhet t'i përmbush kërkesat e parapara në Dosje të Tenderit.

7. PC per hostim të pavarur të CMS Server app, me instalim dhe konfigurim – gjithsej 1 copë
HW Platfrom to host Digital Signage CMS server app. Equivalent or better: Working Station: G9 i7, Intel i7, 16GB RAM, 512GB SSD, Windows11 PRO Licensed; Monitor - LED 22", Full HD

7	PC për hostim të CMS Server app - me instalim dhe konfigurim	copë	1		

Foto e parë nga Dosja e Tenderit, foto e dytë nga lista e çmimeve

Pra, kjo është komplet e paqëndrueshme dhe qëllimin e ka për të justifikuar anulimin e aktivitetit të prokurimit, konkretisht për të realizuar qëllimin kryesor e që është mos shpërblimi me kontratë me çdo kusht për OE-në STORM ICT.

Në asnjë formë nuk mund të arsyetohet qëndrimi i AK-së se kemi të bëjmë me kinse ndryshime materiale, të gjithë OE-të kanë pasur qasje të pakufizuar në Dosje të Tenderit por edhe në përshkrim të çmimeve, dhe nëse eventualisht dikush do të kishte mëdyshje do të bënte kërkesë për informata, shtesë ashtu siç e kanë bërë për çështje tjera për të cilat me të vërtetë kanë pasur paqartësi. Në rastin konkret "paqartësi ka pasur vetëm Komisioni i Vlerësimit" i cili ka dalë përtej detyrave dhe përgjegjësive të tij, me qëllimin e vetëm privimi nga shpërblimi me kontratë për STORM ICT dhe atë nëpërmjet anulimit të tërësishëm të aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi 8: Dy OE kanë ofruar çmime identike – dyshim për marrëveshje të ndaluar

AK pretendon se STORM ICT dhe OE tjetër konkurrent kanë marrëveshje të fshehtë për të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit sepse disa pozicione i paskan ofertuar me çmime gati identike, madje duke pretenduar se qenka shkelur edhe Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Fillimisht duhet theksuar se AK ASNJËHERË neve si OE nuk na ka kërkuar informata shtesë (sipas nenit 72 të LPP-së) lidhur me këto çmime si dhe nuk ka provuar me asnjë fakt apo provë të vetme se potencialisht kemi të bëjmë me marrëveshje të ndaluar. Pastaj, AK përmend se për këtë çështje qenka shkelur dispozita e nenit 7 të LPP-së, e kjo dispozitë FARE nuk ka të bëjë me atë që pretendohet nga AK.

AK nuk ka treguar se si qenkemi marr vesh me OE-në konkurrues, cili paska qenë interesi që ta bëjmë një "marrëseje të tillë", dhe tjetra që është shumë e rëndësishme pse nuk u morrëm vesh që të dy OE-të të jemi të përgjegjshëm, rrjedhimisht "të qohet deri në fund kjo skemë mashtrimi sipas AK-së".

Si argument shtesë se STORM ICT asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk është e kyçur në këso lloj skemash, e tregon fakti që për aktivitetin e njëjtë të shpallur nga AK gjatë vitit 2023, ne kemi ofruar çmim total prej 49,250 euro, ndërsa në këtë aktivitet 49,910, pra diferenca është më pak se 700 euro.

PROVË: ***- Procesverbali i hapjes i aktivitetit paraprak të anuluar me numër të prokurimit 101-23-3902-1-2-1 dhe Procesverbali i hapjes në aktivitetin e tanishëm***

Sidoqoftë, ky pretendim i AK-së përveç që është i pabazuar në LPP dhe i pa argumentuar, në të njëjtën kohë është krejtësisht jo relevant dhe ka vetëm një qëllim, "frikësimin" e OE-ve që të mos e ndjekin të drejtën e tyre ligjore për Vendimin e kundërligjshëm të AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi 9. Çmim i pazakontë i ulët dhe mospërputhje me vlerësimin e njësisë kërkuese

AK pretendon se të dy OE-të në garë kanë ofruar çmim shumë të ulët për pozicionin nr.7 dhe këtë nuk e mbështet në matjen e vlerës së tregut, as në ofertat tjera të OE-ve konkurrues, por e bazon kinse një "vlerësim" të njësisë së kërkesës e cila as nuk faktohet e as nuk dihet se si është bërë. Gjithashtu, AK nuk e aplikon fare mundësinë për informata shtesë sipas nenit 61, lidhur me nenin 72 të LPP-së lidhur me këtë pozicion, por vendos që në mënyrë krejtësisht të pavarur dhe mbi bazën e asaj se "njësia kërkuese paska vlerësuar një çmim më të lartë" t'i trajtoj çmimet në këtë pozicion si jo normalisht të ulët. Andaj kjo mënyrë e vendosjes është arbitrare dhe e pa bazuar në LPP dhe as në praktikë të prokurimit publik. Konkretisht kjo bije ndesh me nenin 7 dhe 59, 61 dhe 72 të LPP-së.

Pretendimi 10. Pozicioni 7- ofrimi i dy prodhuesve nga OE STORM ICT dhe ndikimi i paqartësisë në dokumentet e tenderit

AK pretendon se oferta e OE STORM ICT për pozicionin 7 nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit për shkak se në paramasë janë ofruar dy emra prodhuesish të ndryshëm.

Ky pretendim është krejtësisht i pabazuar dhe është në frymën e asaj se kinse AK i ka hamendësuar OE-të se kinse tjetër gjë është kërkuar në Dosje të Tenderit e tjetër në paramasë. OE STORM ICT ofertën e tij e ka krejtësisht në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe arsyeja pse është ofertuar edhe me prodhuesin Dell por edhe me Lenovo është për faktin se në këtë pozicion sipas Dosjes së Tenderit kërkohet edhe PC edhe MONITOR, prandaj për PC prodhuesi është Dell, ndërsa për Monitor prodhuesi është Lenovo.

Kjo çështje është krejtësisht e qartë, dhe aspak nuk mund të konkludohet se kinse kemi të bëjmë me shkelje të nenit 59.4 të LPP-së, sepse oferta e STORM ICT i përgjigjet 100% kërkesave të Dosjes së Tenderit, dhe çdo vendosje ndryshe në këtë pozicion, pastaj do të përbënte bazë të mjaftueshme për eliminim.

Gjithashtu, as për këtë çështje AK nuk ka kërkuar sqarime nga ne sipas nenit 72, ku do t'i sqaronim se ne kemi ofertuar pikërisht sipas kërkesave të AK-së, andaj pretendimet se OE STORM ICT është i papërgjegjshëm mbi këtë bazë janë krejtësisht jo ligjore.

Pretendimi 11. Mospërputhja administrative – mosplotësimi i formularit "përshkrimi i çmimit" nga OE Botek SHPK.

Ky pretendim i AK-së është plotësisht i drejtë, STORM ICT pas sigurimit të dokumenteve ofertuese nga OE Botek SHPK ka parë se nuk është plotësuar konformë kërkesave të LPP-së paramasa, andaj si i tillë i njëjti OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm dhe rrjedhimisht të rekomandohet për kontratë STORM ICT si i vetmi OE i përgjegjshëm.

Andaj pas administrimit të provave dhe fakteve të paraqitura në këtë Ankesë, OSHP-së i rekomandojmë që të nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** Ankesa e OE STORM ICT LL.C. si e bazuar dhe e ligjshme.

II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 17.06.2025, lënda kthehet në **RIVLERËSIM**, ashtu që **DETYROHET** AK të Rivlerësoj aktivitetin konform gjetjeve të Panelit.

III. Meqë ankesa ishte e suksesshme, OE STORM ICT LL.C. i kthehet tarifa për ankesë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, ashtu edhe në fitime të munguara. Konkretisht dëmet e pësuara deri në këtë fazë të procedurës janë rreth 30,000 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

AVOKATURA ARIFI & PARTNERS SH.P.K.
Avokat Qëndrim Arifi
+383 49 875 852
avokatura.ap@gmail.com
Rr. Idriz Gjilani, Llam.15, K. II, Nr.213, përballë bibliotekës "Hivzi Sylejmani", Dardani, Prishtinë

AUTORIZIM

Operatori Ekonomik **STORM ICT L.L.C.** , me NUI: 810831124, me seli Rruga Tahir Zajmi Prishtinë, e autorizon Avokat **Qëndrim Arifi**, me seli Rr. "Idriz Gjilani", Llam. 15, Kati II, Nr. 213, Dardani, Prishtinë, për ta përfaqësuar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *"Digital Signage - Krijimi dhe mirëmbajta e sistemit të integruar Digital Signage në tërë ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës", me numër 101-25-3586-1-2-1.*

Avokati autorizohet që të ushtrojë të gjitha veprimet juridike, por duke mos u kufizuar si në vijim:

- Që të më përfaqësojë para organeve administrative, çdo gjykate të rregullt, institucioneve përmbarimore, kompanive të sigurimeve ose organi tjetër kompetent shtetërorë apo administrativ, të iniciojë procedurë civile/penale/administrative, të ndërmarrë çdo veprim juridik për të firmosur dokumente të nevojshme për realizimin e të drejtave në procedurë gjyqësore penale, kundërvajtëse, administrative, doganore, fiskale, tatimore apo civile apo edhe pranë organit tjetër kompetent dhe institucioneve tjera zyrtare në tërë territorin e Kosovës. Përfshirë këtu, të ushtrojë mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike dhe nga të njëjtat të heqë dorë ose të tërhiqet prej tyre, e me këtë të më përfaqësojë edhe në gjykatë më të larta sipas shkallshmërisë.

Ky autorizim është deri në përfundim të rasteve/lëndëve për të cilat është dhënë, mirëpo mund të revokohet edhe më parë, në mënyrën dhe procedurën e paraparë me ligj ose me kontratë nëse palët kanë nënshkruar një të tillë. Autorizimdhënësi e ka të qartë se me avokatin duhet të jetë i sinqertë dhe bashkëpunues, si dhe zotohet se do të ofroj të dhëna të sakta për rastet në të cilat i autorizuari është i angazhuar. Çdo veprim që do ta bëjë i autorizuari im, konsideroj se e kam bërë vet.

Autorizimdhënësi pranon që shërbimet e avokatit do t'i paguaj konformë marrëveshjes apo sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK). Në rast nevoje avokati përkohësisht këtë autorizim mund ta bartë pjesërisht apo në tërësi tek personat tjerë profesionist, me autorizim zëvendësues pa pas nevojë që të marr pëlqimin tim paraprak.

Autorizimi vlen deri në përfundim të çështjes gjegjësisht në kohë të pacaktuar.

Këtë autorizim e vërtetoj me nënshkrimin tim të dhënë më poshtë.

Autorizimdhënësi:

STORM ICT L.L.C.

LIMITED LIABILITY COMPANY STORM ICT L.L.C. I PRISHTINË

Datë: 20.06.2025

AVOKAT / LAWYER
Qëndrim Arifi
AVOKATURA ARIFI & PARTNERS SH.P.K.